

K Ë R K E S Ë

PËR SHPALLJEN TË VDEKUR TË TAHIR REÇIT

Në Gjykatën e Rrethit Mat është paraqitur kërkesë nga Sahate Reçi për shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj Tahir Reçi:

Kërkuese: Sahate Reçi, e bija e Hal dhe Bibës , datëlindja 1920, lindur në Ulëz, banuese në Ulëz, pa arsim.

Objekti: Shpalljen si të vdekur të ish-bashkëshortit tim Tahir Reçi më 23 gusht 1986 dhe përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë.

Baza ligjore: nenet 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe 348 e vijues të Kodit Civil.

Gjykatës së rrethit Mat,

Bashkëshorti im Tahir Reçi është zhdukur nga shtëpia në 23 gusht 1986. Me gjithë kërkimet e bëra për 10 vjet nga ne familjarët dhe nga organet kompetente, nuk ka qenë e mundur gjetja e tij. Në këto kushte, meqenëse nuk ka asnjë të dhënë për dhjetë vjet dhe nuk ka qenë e mundur gjetja e tij, kërkoj të deklarohet si i vdekur, meqenëse ai ka qenë dhe i moshuar në kohën kur është zhdukur. Lidhur me sa parashtrova si dhe për çka do të shihet e nevojshme mund të pyeten dëshmitarët Rexhep Kola dhe Gjin Malci nga Ulza.

Pasi të përcaktohet vdekja e tij, kërkoj të çelet trashëgimia ligjore, ku si trashëgimtarë të radhës së parë jam unë, bashkëshortja e tij, Sahatja dhe djali i tij, Haxhi Reçi.

Për sa parashtrova më lart kërkoj pranimin e kërkesës

KËRKUESE
Sahate Reçi